

RAPORT PUNE 2017

DREJTORIA E SHËNDETËSISË
DHE E MIRËQENIES SOCIALE
KOMUNA E GJAKOVËS

AKTIVITETET E :

- ZYRES SË DSHMS;**
- KUJDESIT PARËSOR SHËNDETËSORË;**
- QENDRËS PËR PUNË SOCIALE**

PËRMBAJTJA

- 3 SHËRBIMET E DREJTORISË SË SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
- 4 MISIONI
- 5 BUXHETI I DSHSM 2017 (Sektorët dhe % e shpenzimit të buxhetit 2017)
- 6 SHPENZIMI I BUXHETIT, PREJARDHJA E BORGJEVE DHE MENAXHIMI I TYRE
- 7 ÇKA U PUNUE NË DSHSMS 2017 (ZYRJA) LËNDËT
- 8 ÇKA U PUNUE NË DSHSMS 2017 (ZYRJA) AKTIVITETET SOCIALE
- 9 ÇKA U PUNUE NË DSHSMS 2017 (ZYRJA) PROJEKTET 2017

- 10 SEKTORI I KUJDESIT PARËSORË SHËNDETËSORË (K.P.SH.)
- 11 VEPRIMTARIA NË K.P.SH. – Sa punoi Personeli në KPSH Gjakovë gjatë 2017
- 12 VEPRIMTARIA NË K.P.SH. – Pse u mblodhën të dhënat
- 13 VEPRIMTARIA NË KPSH.-Sasia e Shërbimeve shëndetësore nga K.P.Sh.
- 14 VEPRIMTARIA NË K.P.SH. - Llojet e shërbimeve (Dg)
- 15 VEPRIMTARIA NË K.P.SH.- Moshat
- 16 VEPRIMTARIA NË K.P.SH. – Cilësia në ofrimin e shërbimeve
- 17 TË DHËNA SHITESË- Pasqyrimi i shpenzimeve në Laboratorin Biokimik-Hematologji
- 18 TË DHËNA SHITESË- Shpenzime të karburanteve në Autopark të K.P.Sh.
- 19 TË DHËNA SHITESË - Bashkë-pagesat në K.P.Sh.

- 20 QENDRA PËR PUNË SOCIALE – SNS 2017
- 21 QENDRA PËR PUNË SOCIALE – Shërbimi social 2017

SHËRBIMET E DREJTORISË SË SHËNDETËSISË DHE TË MIRËQENIES SOCIALE

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale duke u thirrur në obligimet ligjore (Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale /03L-040/, Statutin e Komunës së Gjakovës /01 Nr.011-332/2010 dt. 26.12.2008/), Ligjin për Shëndetësi /04/L-125,Neni 18/ dhe udhëzimet administrative përkatëse /U.A. shëndetësi Nr.02/2015;e 13/2002,/ si dhe rregullat tjera ligjore (nga M.SH.P. dhe MEF,etj), në kuadër të angazhimeve të saja ofron këto shërbime:

- Planifikon dhe orienton strategjinë e Kujdesit Parësorë Shëndetësorë (K.P.Sh.);
- Vlerëson nevojat dhe objektivat lokale për K.P.SH.;
- Planifikon, propozon dhe implementon buxhetin, bazuar në nevojat lokale, duke ju përmbajtur udhëzimeve të Ministrive përkatëse (M. Sh. dhe MEF).
- Monitoron mbledhjen dhe shpenzimin e bashkë-pagesave brenda kornizës së caktuar nga M. Sh. (sipas U.A.04/2007).
- Monitoron ofrimin e shërbimeve shëndetësore për popullatën dhe aktivitetin në KPSH (QKMF;QMF e AMF);
- Monitoron ofrimin e shërbimeve të shëndetit oral në K.P.Sh;
- Monitoron shëndetin publik. Përmirësimi i gjendjes shëndetësore i popullatës përmes të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit, promovimit të shëndetit, edukimit shëndetësorë, marrjen e masave kundër epidemive; eliminimin e shkaktarëve dhe parandalimin e sëmundjeve epidemike. Imunizimin dhe vaksinimin. Bashkë koordinon aktivitetet për mbi-këqyrjen e situatës epidemiologjike në nivel komune e lidhur me marrjen e masave preventive për mbrojtjen shëndetësore të popullatës;
- Monitorimin dhe zbatimin e normave dhe të standardeve të infrastrukturës, burimeve njerëzore të miratuara nga M. Sh.;
- Mbledhjen dhe analizimin informatave (shëndetësore) në nivel lokal;
- Përcakton prioritet lokale dhe objektivat në përputhje me strategjinë e KPSH;
- Shërbehet me të dhënat e nivelit qendrorë për të analizuar cilësinë e shërbimeve dhe përdorimin efektiv të burimeve.
- Zbatimin e ligjit të Shëndetësisë dhe rregulloreve që i lëshon M. e Shëndetësisë,etj.
- Ndërmarrjen e fushatave senzibiluese për promovim shëndeti me organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare;
- Raportimi mbi ofrimin e shërbimeve dhe të arriturave komunale në lëmin e shëndetësisë;
- Mbikëqyrjen e mirëqenies së banorëve në ndërtesat për banim social;
- Monitorimin e buxhetit dhe aktiviteteve të Qendrës së Punës Sociale;
- Planifikimi dhe shpërndarja subvencioneve shëndetësore Komunale;
- Shqyrtimin e lëndëve të ndryshme të ardhura nga banorët e Komunës;
- Evidentimin e të dhënave lidhur me të gjitha kategoritë e dalura nga luftërat (invalidët civil dhe të luftës, për të zhdukur dhe të burgosur,etj).
- Bashkëpunimin me shoqatat e njerëzve me nevoja të veçanta;
- Dhënia e aplikacioneve për trajtim (mjekim) jashtë vendit për Ministrinë e Shëndetësisë.
- DSHMS përveç sa u përmend, ofron edhe këto shërbime:
- Plotëson aplikacion për trajtim jashtë vendit;
- Pregaditë kushtet dhe rrethanat për shpërndarjen e fondit për Subvencione shëndetësore;
- Pregaditë kushtet dhe rrethanat për shqyrtim të kërkesave për Strehim social;
- Ju përgjigjet kërkesave të ndryshme të ardhura (në DSHMS);
- Lëshon Vërtetime të ndryshme (për dëshmorë,etj).

Misioni i DSHMS

DSHMS bashkë rendit dhe mbikëqyr :

- *ofrimin e shërbimeve (specifike të Drejtorisë, K.P.Sh. dhe QPS) në sasi, cilësi dhe llojshmëri për popullatën e Komunës;*
- *avancimin e kushteve të punës së të, të punësuarve, në këta sektorë;*
- *gjithnjë duke u bazua në respektimin e ligjeve përkatëse.*

Vizioni

DSHMS - identifikon nevojat e kërkesat e qytetarëve dhe orienton shërbimet në KPSH dhe QPS në përmbushjen e këtyre kërkesave.

Qëllimi

Plotësimi i nevojave dhe kërkesave të banorëve të Komunës për ruajtje e avancim të shëndetit dhe mirëqenies sociale.

DSHMS aktivitetin e vetë e kryen përmes të:

- Sektorit të Kujdesit Parësorë Shëndetësorë;
- Sektorit të Mirëqenies Sociale;
- Sektorit financiar të DSHMS;

- Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (Kujdesin Parësorë Shëndetësorë);
- Qendrën për Punë Sociale;

Personeli i paraparë në DSHMS gjithsejtë 377 vetë dhe atë:

- 6 individ në zyre DSHMS;
- 353 individ në KPSH;
- 18 individ në QPS;


BUXHETI 2017 DSHMS

SHPENZIMI I BUXHETIT 2017 DSHMS

NUK U LLOGARITËN pasi që detyra dorëzohet në muajin Nëntor 2017, rrjedhimisht nuk posedojmë të dhënat përfundimtare të shpenzimit të buxhetit.

Në vijim në tabelë (& grafikun) paraqitet se si është shpenzuar buxheti i DSHMS-së për në periudhën kohore Janar –Tetor 2017.

LLOJI I SHPENZIMIT	BUXH.SHPENZ.
PAGA	2,095,618.87
M&SH	186,000.00
KOMUNALE	40,000.00
KAPITALE	38,964.00
SUBVENCIONE	400,000.00
Donacione	168,022.00
GJITHSEJTË	2,928,604.87



**SHPENZIMI I BUXHETIT,
PREJARDHJA E BORXHEVE DHE MENAXHIMI I TYRE**

Tabela në vijim paraqet trashëgimin e borxhit nga viti 2013 dhe menaxhimin e borxhit në DSHMS gjatë 2014 ;2015 dhe 2016 ;

*Të dhëna të siguruara nga `free balance`.

BORXHET E SHKAKTUARA GJATE VITIT	M & SH	KOMUNALE	
2013	96,212.00	19,751.00	115,963.00
2014	39,111.00	1,260.00	40,371.00
2015	34,381.00	3,902.00	38,283.00
2016	45,512.00	11,586.00	57,098.00

Nga tabela ju mund të njoftoheni se DSHMS ka trashëguar (nga viti 2013) borxh në kategorinë Mallra dhe Shërbime si dhe në Komunali në vlerën prej 115,963.00 €.


Njëkohësisht, me vendim Gjykate, për borxhe të viteve të mëparshme të Drejtorisë së Shërbimeve Publike gjatë vitit 2014 i janë konfiskuar 65,573.6 € dhe po për të njëjtat arsye ka pas konfiskime të mjeteve edhe gjatë vitit 2017.

Sado që kemi kryer kursime vlere e tillë e borxhit të trashëguar i ka lënë pasojat për vitet në vijim.

ÇKA U PUNU NË DSHMS 2017 / ZYRJA -Lëndët

Gjatë periudhës Janar – Tetor 2017 në DSHMS janë pranuar dhe shqyrtuar 514 lëndë të ndryshme nga banorët e Komunës.

Në grafikon paraqiten kategorit (llojet e lëndëve dhe numri i tyre).



*Mesatarisht, në DSHMS kanë ardhë (dhe shqyrtuan) nga 2 lëndë në ditë !

CKA U PUNU NË DSHMS 2017 / ZYRJA- AKTIVITET SOCIALE

***Komisioni Komunal për Ri-integrim** (i cili kryesohet nga DSHMS),) gjatë vitit 2016 u mblodh 10 herë dhe shqyrtoi 94 lëndë (kërkesa). Në tabelë po i paraqesim llojet dhe sasinë:

Kërkesa	Aprovuara	Refuzuara
Banim me qera	25	4
Asistence Sociale (pako ushqimore dhe higjienike	25	
Pako e dimrit (dru për ngrohje)	10	
Trajtim Mjekësor	5	
Ndryshme		
Gjithsejtë	65	4

***Bashkëpunimi ndër-fetar.** Më kërkesa të OSCE kemi vendos që komuniteti fetar të e ketë një pikë takim në Komunë (DSHMS) së paku një herë në vit (dhe sipas nevojës) për aspektet e ndryshme fetare dhe ndër fetare. Në këtë grupe punues janë të ftuar pjesëtarët e Bashkësisë Islame; Ipeshkvi-së; Sekteve të ndryshme- Sheh-lerë, Sektit Bektashian, edhe pjesëtarët e Kishës Protestante, Evangjelistë dhe sekteve të tjera (të mundshme) që kryejnë veprimtari fetare në Komunë të Gjakovës.

Sektori i Mirëqenies Sociale në DSHMS. – Llojet e vërtetimeve të lëshuar gjatë vitit 2016

Vërtetimet e viktimave civile	78
Vërtetime për dëshmore	5
Vërtetime për te zhdukur	10
Vërtetime për invalid te UÇK-te	2
Plotësimi i librezave të invalidëve civil të luftës se fundit (1998-99)	7
Invalid civil	
Dëshmi- Libreza te reja për Invalid civil	1
Gjithsejtë	103

CKA U PUNU NË DSHMS 2017 / ZYRJA- PROJEKTET 2017

Investime në objekte (ndërtesa).

Në KPSH:

1. Inicimi i procedurave të prokurimit dhe fillimi i punimeve në ndërtimin e objektit të ri të QKMF.
2. Ndërtimi i objektit- Qendër të re rehabilitimi me Bazë në Komunitet (RBK) për nevoja të Handikos-Gjakovë.
3. Projekti renovimet e objekteve në KPSH (renovime në 11 objekte QMF dhe AMF).
4. Furnizim me pajisje mjekësore dhe jo mjekësore (Laboratore doracake;etj)

Projekte ekzistenciale (hapje të tenderëve) për funksionim të sistemeve në K. P. Sh. dhe Q.P.S.):

- Furnizim me Material për laborator biokimik hematologjik;
- Furnizim me Material harxhues stomatologjike;
- Mirëmbajtje e objekteve / pastrimi (27 objekte në K.P.Sh dhe 1 QPS);
- Sigurimi fizik i objektit;
- Furnizim me Material zyrtare/shtypur; dhe mjekësor (nga M. Sh.)
- Mirëmbajtje e automjeteve;
- Furnizim me naftë për ngrohje;
- Furnizim me dru;
- Furnizim me Derivate për automjete;
- Mirëmbajtje e pajisjeve informat. dhe aparat. fotokopjuese;
- Reprerentacion;
- Furnizim me barna emergjente;

Donacion. Nga OJQ `Flatra` me seli në Shtuttgart, Gjermani kanë sjellë një automjet transportues (8+1) për të i ndihmua transportimin e pacientëve që vuajnë nga pamjaftueshmërisë së punës së veshkave (Insuff. chr. renailis- dialysis facta).

SEKTORI I KUJDESIT PARËSORË SHËNDETËSORË (K.P.SH.) 2017

Kujdesi Parësorë Shëndetësorë në Komunë të Gjakovës:

1. Aktivitetin e vetë e bazon në Ligjin e Shëndetësisë dhe aktet normative të tij;
2. Vizitat e shërbimet shëndetësorë i ofron sipas Klasifikimit Ndërkombëtar ICD 10;
3. Ofron shërbime shëndetësorë për popullatën e Komunës së Gjakovës gjithsejtë 94557 banorë (sipas rexhistrimit të viti 2011);
4. përbëhet nga:

Personeli profesional (353 individ) :

- Specialist i Mj. Familjare
- Doktor i Mjekësisë
- Internisti- Konsult.
- Peditër- Konsult.
- Infermier
- Farmacist
- Teknik i Farmacist
- Teknik i Laborant
- Spec. Stomatolog (Sektori Sek. Stomatologjik)
- Doktor Stomatolog
- Teknik i dhëmbëve
- Asistente stomatologjisë
- SISH
- Administrata
- Shofer-Parku i automjeteve
- Shërbimi teknik


Objektet (27) :

- QKMF
- QMF "E. DURAKU"
- QMF "ÇABRAT"
- QMF BERKOC
- AMF DOL
- QMF "ORIZE"
- QMF "ERENIKU"
- QMF PONOSHEC
- AMF GUSKË
- AMF KORENICË
- AMF BABAJ BOKES
- AMF MULLIQ
- AMF SHEREMET
- QMF SKIVJAN
- AMF NOVOSELLE
- AMF DUJAKË
- QMF CERMJAN
- AMF BEC
- AMF GERGOC
- AMF KRALAN
- AMF SHQIPONJE
- AMF DOBLIBARE
- QMF ROGOVE
- AMF BISHTAZHIN
- AMF LIPOVEC
- AMF DAMAJN
- QMF DARDANI

VEPRIMTARIA NË KPSH 2017 - Sa punoi Personeli në K.P.Sh. Gjakovë gjatë 2017 ?

Në vijim në tabelë (& grafik) paraqitet numri i vizitave dhe shërbimeve shëndetësorë të ofruara në K.P.Sh. (Mjekësi Familjare dhe Stomatologji) gjatë vitit 2017 (Janar –Tetor 2017).

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
Viz. Shënd	13653	18335	20406	15004	17069	14967	15596	18047	15265	17227			165569
Sh. Shënd	29375	33232	38125	33546	43876	27873	28227	33307	30565	33439			331565



Koment.-

Banorëve të Komunës (gjate 10 muajve / Janar-Tetor) të vitit 2017 i janë:

- ofruar **165569 Vizita të pacienteve** dhe
- ofruar **331565 Shërbime Shëndetësore.**

VEPRIMTARIA E KPSH 2017 -Pse mblidhen dhe prezantohen këto të dhëna ?

Këto të dhëna mbledhjen për të u plotësua formula e kërkuar nga Ministria e Financave (& Ministria e Shëndetësisë) me anë të së cilës llogaritet buxheti i KPSH-së nga granti (qeveria) qendror, shih tabelën:

Njoftim shtese. TË DHËNAT NË VIJIM LLOGARITEN VETEM PER PERIUDHEN JANAR TEOTR 2017 (pra vetëm për periudhën prej 10 muajve).

2017 (24.11.2017)	R Vjetor	Regj 2011	€ Vizita per Capitam	€			
Viz. per-capitam	165569	94557	1.750996753	4	7.003987		
SH.SH. Per-capitam	331565	94557	3.506509301	3.9	13.675386		
	R Vjetor	Regj 2011	€ SH.SH. Per-capitam		20.679373	94557	1955379.5
					Total	Regj 2011	
					per capitam		

Komentet nga tabela (formula e prezantuar):

*Numri i popullatës sipas regjistrimit te vitit 2011 është 94557 (banorë)


*Të dhënat në vijim paraqesin bazën e llogaritjes së grantit të buxhetit për K.P.Sh. dhe performancës:

- Popullatës gjatë vitit 2017 ju ofruan 165569 vizita, gjegjësisht 1.7 vizita për koke banori.
- Popullatës gjatë vitit 2017 ju ofruan 331565 shërbime shëndetësore, gjegjësisht 3.5 shërbime shëndetësore për kokë banori.

*Shpenzimet mesatare të komunës për një vizitë mjekësore nëpër Qendrat Shëndetësor Familjare (Kujdesi shëndetësor primar) gjatë vitit 2017 NUK U LLOGARITËN pasi që Raporti nuk është përfundimtar (sepse u llogarit vetëm për periudhën nga Janari deri në Tetor 2017).

*Numri mesatar i vizitave për një mjek nëpër Qendrat Komunale shëndetësore në vitin 2017 NUK U LLOGARITËN pasi që Raporti nuk është përfundimtar (sepse u llogarit vetëm për periudhën nga Janari deri në Tetor 2017).

Nr.i Shërbimeve Shëndetësore në K.P.Sh. (QKMF; 10 QMF dhe 16 AMF) gjatë Janar-Tetor 2017




VEPRIMTARIA E KPSH 2017 – LLOJET E SHËRBIMEVE (Dg.)

Nga cilat lloje të sëmundjeve (më shpesh) u mjekuan banorët e Komunës në KPSH ?

Në vijim paraqitet tabela (dhe grafikun) për 26 llojet e ankesave (Diagnozave) më të shpeshta që u trajtuan në KPSH (sipas ICD 10 – Klasifikimi Ndërkombëtar i Sëmundjeve).

Dg	J00	J02/J03	J10	J20	J44	N00/N90	I10/I99	E00/E10	M47	M54/M60	A09	L00/L50	R00/R99
Total	10212	24004	3416	5524	1325	3412	17680	4256	4483	2799	6863	5809	9456

Dg	K29/K93	W57	Z00	Z74	S00/S60	G44	B30-B94	D50	F00/F79	H00/H50	H65	C00/C34	T15/T98
Total	5183	62	12689	12069	2213	3234	1473	880	1152	2564	1613	248	1176




Koment.- nga grafikoni shihet se (ndër të tjera) veçohen-dominojnë sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes (që flet për ndotje të ambientit); sëmundjeve të traktit urinar; shtypjes së ngritur të gjakut dhe sëmundjes së diabetit, yndyrës së rritur, (e që flet për keq-ushqyeshmërin e popullatës); sëmundjeve të sistemit muskulo-skeletor; si dhe përshkrimet e ndryshme (që fletë për mungesën e rendit-sigurimeve shëndetësore).

VEPRIMTARIA E KPSH 2017 - MOSHA

Cilat moshë u ankuan më shpesh ? Në vijim paraqitet tabela (& grafikun) për moshat e banorëve që kërkuan ndihmë në KPSH gjatë periudhës Janar-Tetor (viti) 2017.


Moshat	24 orë	Deri 1 Jave	Deri 1 Muaj	Deri 6 Muaj	deri 1 Vjeq	1 deri 3 Vjeq	3 deri 6 Vjeq	6 deri 18 Vjeq	18 deri 65 Vjeq	mbi 65 Vjeq		
									F	M	F	M
Gjithsejtë	16	1457	1340	2641	5192	11295	14191	35361	46929	37906	19567	16551



Koment- Nga tabela (& grafikun) shihet se popullatës qysh në moshë të re (taksa-paguesit) i fillojnë ankesat. Kjo e dhënë shërben si dëshmi për arsyetimin e punës së Kujdesin Parësorë Shëndetësorë dhe arsyetimi për investim në këtë sektor (K.P.Sh.) në mënyrë që të zhvillohen programe për parandalim të sëmundjeve që mund të parandalohen, si p.sh. edukim shëndetësor, përmirësimi i ambientit, mënyrës së të ushqyerit, aktivitete fizike etj.

VEPRIMTARIA E KPSH 2017 - CILËSIA

A respektuan rekomandimet e OBSH-K.B. (ËHO-UN) lidhur me cilësinë – sasinë e referimit ? Në vijim paraqitet tabela (& grafikun) për % e referimit nga K.P.Sh. në sistemet tjera shëndetësore.




Koment.-Nga tabela shihet se % e referimeve është nën 20 % (OBSH rekomandon 20 % referime) e që shpjegohet me :

- moshën e re të popullatës (që është karakteristike për Kosovën) dhe e cila nuk paraqet arsye të madhe për referim në Kujdesin Sekondar Shëndetësore dhe
- angazhimin e kuadrit profesional (Spec të MF, etj.).

TË DHËNA SHITESË – pasqyrimi i shpenzimeve në Laboratorin Biokimik - Hematologjik.

Çmimi i shpenzimeve në laboratorin Biokimik Hematologjik në QKMF

Në grafikun janë paraqitë numri i pacientëve (5069) që morën shërbime që gjatë periudhës (Janar-Tetor) 2017 dhe sasia e mjeteve (7147.19 €) të shpenzuara gjatë vitit 2017 për kryerjen e analizave në Laboratorin Hematologjik- Biokimik.




Koment. Për kryerjen e analizave për një Pacient, gjatë vitit (Janar-Tetor) 2017 (mesatarisht) është shpenzua 1.4 € për material harxhuar-të blerë – reagens, etj.).

TË DHËNA SHITESË – SHPENZIMI KARBUARNETEVE NË K.P.SH.

Gjatë 10 muajve (Janar-Tetor) të vitit 2017 janë shpenzuar 8,308.31 € , në karburante për nevojat të autoparkut të K.P.SH.

Shpjegim shtesë. Në vijim paraqitet tabela dhe grafiku që e shpjegojnë sasinë e mjeteve (€) të shpenzuara për karburante në KPSH (gjatë vitit 2013, 2014, 2015,2016 dhe 2017(Janar Tetor 2017)

	2013	2014	2015	2016	2017
JANAR	1582.71	1475.18	1010.3	816.03	805.78
SHKURT	1729.52	1323.23	1080	752.76	899.7
MARS	1845.86	1796.4	963.55	758.76	793.88
PRILL	1679.01	1593.75	1090.15	765.85	842.4
MAJ	1722.52	1514.29	1,016.80	837.43	837.439
QERSHOR	1642.13	1469.65	997.57	801.72	718.14886
KORRIK	1829.11	1484.15	951.3	907.99	806.7
GUSHT	1526.62	1330.7	1016.29	772.38	914.74094
SHTATOR	1884.58	1567.63	1016.29	856.04	787.75
TETOR	2086.26	1624.35	1340.3	827.1	901.7742
NENETOR	1802.75	1252.8	713.2	827.0955	
DHJETOR	1626.81	1301.55	816.03	916.59	
TOTALI	20,957.88 €	17,733.68 €	12011.78	9839.7455	8,308.31



Koment.-Nga të dhënat në (tabelë & grafik) shihen mjetet (€) e shpenzuara dhe **trendi i kursimeve në shpenzimin e karburanteve** në autoparkun e K. P. Sh.

BASHKË- PAGESAT në KPSH 2017 / Mblidhen sipas U.A.04/2007.

Në tabelën në vijim janë paraqitur vlerat e mbledhura të bashkë-pagesave në KPSH për 10 muaj (Janar-Tetor) gjatë vitit 2016. Gjithsejtë 45,782.50 €.

Këto mjete janë paguar nga 31878 Pacientë/ Klientë (apo 22% e të te vizituarve-).

Të liruar janë 112072 (apo 78 %) (pacientë që kanë qenë të liruar nga pagesa e shërbimeve me arsyetime të ndryshme të bazuara në U.A përkatës.).

Muaji	Gjithsej €	Gjithsej paguar	Gjithsej liruar	Gjithsejtë
1	4,180.50	2870	8430	11300
2	4,398.50	3085	12515	15600
3	5,231.00	3479	14071	17550
4	3,664.50	2617	10183	12800
5	4,466.00	2915	11835	14750
6	3,838.50	2872	10478	13350
7	4,465.00	3215	10635	13850
8	6,456.50	4580	11720	16300
9	4,578.50	3103	10247	13350
10	4,503.50	3142	11958	15100
11				
12				
	45,782.50	31878	112072	143950
		22%	78%	100%



Koment.-Në tabelë (& grafikun) shihet qartë se gjatë vitit 2017 (10 muaj) bashkë-paguan vetëm 22 % e të, të vizituarve, në KPSH, ndërsa 78 % ishin të liruar-nuk paguan).*Lirimi kryhet duke u bazu në Ligj për Shëndetësi (04/L-125 - për shëndetësi) dhe Udhëzim Administrativ përcjellës.

Ky fakt e vështirëson funksionimin (mirëmbajtjen) e K. P. Sh.

CKA U PUNUE NË QENDRËN PËR PUNË SOCIALE - SNS

Shfrytëzuesit e SNS (Skema e Ndhmës Sociale në Gjakovë).

Tabela në vijim paraqet të dhënat të cilat tregojnë për secilin muaj, sa familje janë përkujdes; sa anëtar dhe sa mjete financiare janë shpenzua nga buxheti i Kosovës.

Muaji	Numri i familjeve	Numri i anetarve te familjes	Shuma e tersishme mujore
1	983	4013	90,702.50
2	973	4014	90,323.75
3	1013	4128	96,650.00
4	997	4043	91,248.75
5	980	4128	96,650.00
6	984	3985	91,393.75
7	970	3935	89,148.75
8	965	3930	89,376.25
9	961	3898	88,165.75
10			
11			
12			

Shënim shtesë. Të dhënat janë prezentuar nga Raporti Mujor i Qendrës për Punë Sociale. Këto mjete shpërndahen nga komisioni përkatës i Ministrisë së Punës dhe i Mirëqenies Sociale.

SHËRBIMI SOCIAL GJAKOVË - Shërbimi Social (Janar Dhjetor 2016)

Meqenëse ky Raport përpilohet në Nëntor 2017 rrjedhimisht nuk i kemi të dhënat përfundimtare lidhur me llojet e aktiviteteve dhe nr. i rasteve që punëtorët e QPS u përkujdesën gjatë 2017.

Raporti i përpilua bazua në raportimet e rregullta mujore e të mbledhura brenda (1 muaj) vitit 2017.

Për çdo interesim-njoftim shtesë, pa qartësi, rekomandim, ankesë ju mund të më njoftoni në adresat e bashkangjitura.

Basri Komoni
Drejtor /
Drejtorja e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale
Deptment of Health and Social Ëelfare
Odeljenje za Zdravstvo i Socijalnu Zastitu



Komuna Gjakovë
Municipality of Gjakova
Opština Djakovica

Add: Nëna Terezë, Gjakovë-Kosovë, 50000

Tel.: +381 (0) 0390 322 270

Tel.: +377 (0) 44 233 985

Tel : 386 (0) 49 921 114

E-mail: basri.komoni@rks-gov.net; basrikomoni@gmail.com